



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe nenit 3, 4 dhe 5 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës 15Nr. 011-23133 e datës 06.05.2015, duke vendosur sipas kërkesës së OJQ "HandiKos", Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 330 € (treqind e tridhjetë euro), OJQ "HandiKos" Lipjan, sipas kërkesës së datës 08.11.2016.

Shuma e cekur në paragrafin paraprak i ndahet për ta mbështetur financiarisht për Shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me aftësi të kufizuara fizike 3 Dhjetori.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2016 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyren e Kryetarit në xhirollogarinë bankare të OJQ-së nr. 1907960372031135 në Banken Kombëtare Tregtare.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara deri në shumën e lejuar, OJQ "HandiKos" duhet të sjellë raportin financiar duke i bashkëngjitur faturat. Raporti dorëzohet në Zyren e Kryetarit – Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore dhe i cili duhet të jetë në përputhje me nevojat e paraqitura në Kërkesë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohet OJQ "HandiKos".

1Nr. 400-61781
Lipjan, më 09.11.2016

